

EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri

PËR: Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Z. Jakup Krasniqi
Anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës

NGA: OJQ EC Ma Ndryshe, në emër të nëntë organizatave të poshtënjshkruara
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv i EC Ma Ndryshe

DATË: 21 tetor 2011, Prishtinë

LETËR E HAPUR

Në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit të projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

I nderuari Z. Krasniqi,
Të nderuar anëtarë të Kryesisë së Kuvendit,

Edhe pse kanë kaluar mbi një muaj nga dita e dorëzimit, Kuvendi i Kosovës ende nuk është deklaruar, por as nuk ka hyrë në dialog me OJQ-të sponsorizuese në lidhje me Peticionin e qytetarëve të Prizrenit për projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Ne besojmë se mbi 10.000 qytetarët e nënshkruar e meritojnë një deklaram zyrtar nga Kuvendi i Kosovës në lidhje me qëndrimet dhe kërkesat e tyre rreth këtij projekt-ligji.

Derisa Kuvendi i Kosovës nuk po deklarohet rreth Peticionit dhe nuk po ndërmerr veprime konkrete për të respektuar vullnetin e shprehur të qytetarëve të Prizrenit, po ndodhin shumë veprime të dëmshme për demokracinë në Kosovë. Një rast konkret është tentim-debati i djeshëm me shoqërinë civile i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor. Ky debat është thirrur nga MMPH për të diskutuar rreth projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, që nënkupton proces të konsultimit publik për projekt-ligjin. Projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit aktualisht ndodhet në Kuvendin e Kosovës duke iu nënshtruar shqyrtimit parlamentar, prandaj Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka të drejtë të organizojë konsultime publike dhe të modifikojë përmbajtjen e projekt-ligjit. Me fjalë të tjera, kjo përpjekje e MMPH përbën shkelje ligjore si dhe degradim e nënçmim të autoritetit të Kuvendit të Kosovës.

Për më tepër, përmbajtja aktuale e projekt-ligjit është refuzuar kohë më parë nga Kuvendi i Kosovës në seancë plenare, dy herë nga Komisioni parlamentar për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor, si dhe nga Komisioni parlamentar për të drejtat e njeriut. Edhe përkundër të gjitha refuzimeve, MMPH vazhdon të insistojë dhe të promovojë të njëjtën përmbajtje të projekt-ligjit, si dhe të organizojë konsultime publike në mënyrë joligjore, derisa projekt-ligji gjendet në fazën e shqyrtimit parlamentar. Edhe nëse debatin e djeshëm e konsiderojmë si konsultim të rregullt publik për projekt-ligjin, prapsepse, me mënyrën se si po zhvillohet, MMPH po shkel Rregulloren e Punës e Qeverisë, konkretisht Nenin 32, i cili kërkon që: a) sponsorizuesi të ofrojë informata të mjaftueshme në një formë të kuptueshme nga publiku për t'i mundësuar publikut që të kuptojë natyrën dhe pasojat e propozimit dhe b) të shpallet publikimisht fillimi i procesit të konsultimit dhe të ofrohet kohë e mjaftueshme për publikun dhe OJQ-të që të involvohen në këtë proces. Asnjëra nga këto obligime ligjore nuk po respektohen.

Prizreni nuk është kundër nevojës për të patur një ligj për Qendrën Historike të qytetit, por ne dëshirojmë të kemi një ligj të mirë që do të funksionalizojë qytetin dhe që do të fusë sistemin e menaxhimit urban në qendrën historike të qytetit. Gjithashtu, ne si komunitet dëshirojmë të përfshihemi në procesin e hartimit të një ligji për qytetin nga fillimi deri në fund. Këto dy kërkesa themelore qytetarët e Prizrenit i kanë artikulluar përmes Peticionit të dorëzuar në Kuvend më 19 shtator 2011.

Për të potencuar edhe një herë, përmbajtësisht, ne nuk pajtohemi me tekstin aktual të projekt-ligjit pasi që ai: a) parasheh transferim të autoritetit publik tek autoritetet fetare, b) Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë

i jep kompetenca politike dhe ligjore më shumë se sa që ajo ka në Serbi, c) nuk i merr për bazë politikat dhe dokumentet ekzistuese të KK Prizren, si psh. Plani i konservimit dhe zhvillimit të zonës historike të Prizrenit, d) nuk parasheh kurrëfarë sistemi të menaxhimit urban për qendrën historike, e) parasheh krijimin e një strukture jofunksionale institucionesh që do të menaxhojnë qendrën historike, f) nuk krijon parakushte për zhvillimin ekonomik të qytetit bazuar në resurse të trashëgimisë kulturore, g) krijon pengesa që do të ngufasin potencialin kulturor dhe të trashëgimisë kulturore, h) imponon shumë ndalesa, sanksione, burrokraci, por nuk parasheh kompensime, dhe ka një mori defektesh tjera.

Ne, organizatat e poshtënëshkruara të shoqërisë civile nga Prizreni shprehim pakënaqësinë tonë në lidhje me praktikat jodemokratike dhe diskriminuese të qeverisjes në Kosovë. Konkretisht, jemi të shqetësuar për mënyrën se si po tentohet të miratohet projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit. Në tentim-debatin e djeshëm me shoqërinë civile, të organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe OJQ Urbaniak, është tentuar që në mënyrë klandestine të improvizohet procesi i konsultimeve publike për këtë projekt-ligj. Për më tepër, organizatori i debatit publik ka tentuar të mos lejojë pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve të interesuar në debat, ndërsa mediet kanë qenë plotësisht të përjashtuar duke iu mohuar mundësia e përcjelljes së diskutimeve të debatit. I gjithë ky teatër demokratik i ditës së djeshme e arriti kulmin e shëmtisë së tij me një prezencë frikshme të forcave të rendit duke ushtruar trysni psikologjike (mbi 10 policë në uniformë e po aq civilë e siguri e afërt të pranishëm në sallën e takimit dhe po aq në korridorin e objektit të kuvendit), ofendime, kërcënime e deri në sulme verbale dhe fizike ndaj pjesëtarëve të shoqërisë civile të qytetit. Prandaj, shoqëria civile dhe komuniteti i Prizrenit për të shprehur pakënaqësinë dhe protestën e vet me këto praktika, ka lëshuar sallën e debatit menjëherë pas nisjes së tij, duke i artikuluar të gjitha pakënaqësitë e lartpërmendura.

Në mënyrë që të parandalohet degjenerimi i mëtejme i këtij procesi dhe në mënyrë që të sigurohet respektimi i vullnetit të shprehur kolektivisht i qytetarëve të Prizrenit kërkojmë që Kryesia e Kuvendit të Kosovës të ndërmarrë veprime konkrete në pajtim me këtë vullnet. Njëherit, shprehim gatishmërinë tonë që të hyjmë në një proces të dialogut zyrtar me Kuvendin e Kosovës në lidhje me projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe respektimin e qëndrimeve dhe kërkesave të qytetarëve të Prizrenit të shprehur përmes Peticionit për këtë projekt-ligj.

Organizatat e nënshkruara:

EC Ma Ndryshe,

Fondacioni për Trashëgimi Kulturore,

Forumi për Trashëgimi Kulturore,

Academy for Training and Technical Assistance,

N'GO,

Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren,

GreenArt,

X40,

EUIRC,

Ura e Artit,

Durmish Asllano,

ICEC,

Old timer Club Prizren,

Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri